



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 18. 07. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
2. Avni Olluri, drejtor i DA
3. Shkelzen, Hajdini, drejtor i DEZH

4. Rasim Hasani, drejtor i DKA
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
7. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
8. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
9. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
10. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
11. Vlorë Limani-Hajnuni DSHMS
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
12. Vlorë Krasniqi, zyrtarë ligjorë
13. Besart Troshupa, zyra e informimit
14. Bekim Krasniqi, OJQ "YAGR"
15. Kimete Jashanica, OSBE
16. Kastriot Jahaj, OSBE
17. Bestar Ibrahim,
18. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2019.
3. Propozim vendim për miratimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit të Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor-Shëndetësor (2020-2024).
4. Raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2018.
5. Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.
6. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK Gadime e Ulët.
7. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit në pronësi të Komunës në rrugën "Lidhja e Prizrenit"
8. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve në pronësi të Komunës në sheshin "Adem Jashari"
9. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018.
10. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.
11. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve.
12. Informatë, ecuria e procesit mësimor në periudhën Janar-Qershor 2019.
13. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Albulena Kelmendi, unë edhe në KPF e kam cek se është dashtë drejtori i ujësjellësit me ardh me raportu në Kuvend por po e potencoj edhe tani pse ai drejtor nuk është prezent sot në Kuvend për të raportuar për gjendjen me ujë të pijshëm në Lipjan dhe fshatra pasi që nuk ka aspak përmirësim dhe vetë ai drejtor ka thenë që deri në muajin mars do t'i shihni ndryshimet.

Daut Azemi, është marrë vendim nga Kryetari i Komunës për formimin e taskforces për ujë.

Fauz Xhemajli, ne kemi formua një grup të taskforcës që përbëhet nga inspekcioni i komunës, Shërbimeve Publike dhe punëtorët e ujësjellësit dhe ky grup do të dal me një raport brenda 2 jave për gjendjen me ujë në Komunën e Lipjanit.

Daut Azemi, tha se Kryetari i Komunës të hënën në ora 10 ka një takim me drejtorin e ujësjellësit.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës po e vëj në votim dhe pas votimit konstatoi se 27 vota për, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, kam për t'i ngritur disa çështje të banorëve të fshatit Gllogovc të cilat u paten premtuar në fushatë dhe nuk janë realizuar asnjëherë siqë janë trotuari jo funksional, mirëmbajtja e trotuarit, ndriçimi në disa pjesë të fshatit, i cili nuk ekziston, rregullimi i lumit, furnizimi me ujë, por ajo ma shqetësuesja për këta banorë është mungesa e hapsirave për varreza. Kërkoj nga ekzekutivi dhe drejtorja e kadastrit që këtyre banorëve të ju caktohet një lokacion për varrezat e atyre banorëve.

Lulzim Rustemi, kam dy pyetje, e para komuna duhet të ketë mekanizëm për ta funksionalizuar fontanën – shadërvanin në sheshin “Adem Jashari” dhe e dyta dy drita te shtatorja e Adem Jashari pse nuk i ngjitni, pasi që busti është në terr.

Ramiz Qeriqi, kam një pyetje a është anuluar vendimi i Kuvendit komunal për lokacionin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi, është kanë mirë me na njoftu neve anëtarëve të Kuvendit. E dyta deri kur do të jenë mbishkrimet në gjuhën serbe te lokalet kah Kisha, kur do të kthehen në gjuhën shqipe. Çështja tjetër ka të bëjë me votues e mi unë do të jem në PDK, por nuk e përfaqësoj kryesin e PDK-së në Lipjan por i përfaqësoj votuesit e mi.

Lumturije-Bytyqi-Hasani, unë do ta ngris një çështje e cila është ngritur më herët nga kolegëja Albulena që ka të bëjë me volumin e madhë të lokaleve në sheshin “Adem Jashari”. Muzika e lartë i pengon këta qytetarë dhe lus inspektoriatin që të merret me këtë çështje. Pyetja tjetër pse komuna e Lipjanit nuk e ka bërë dezinfektimin e sheshit “Adem Jashari” nga insektet.

Egzona Bytyqi, kam një pyetje për inspektoriatin e komunës respektivisht inspektoriatin sanitarë se a janë inspektuar pishinat dhe a vazhdojnë të inspektohen pasi që këto ditë është rritur fluksi i madh i qytetarve. Dhe më intereson këto a kanë kontrata me institutin e përcakuar me Ligj ku përfshihen analizat e ujit, kur e dijmë që shpesh herë pishinat po shërbejnë si burim i infeksioneve.

Nazmi Krasniqi, kam për t'i ngritur dy çështje: zgjedhja e kryetarëve të fshatrave deri ku kanë shkuar procedurat dhe emrimi i rrugëve në komunën e Lipjanit.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se zgjidhja e kryetarëve të fshatrave do të filloj në muajin shtator.

Ukë Kryeziu, kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike sa i përket rregullimit të lodrave në fshatin Sllovi ku e lus menaxherin e kontratës që të vepohet sa më shpejt pasi që po ka defekte dhe janë jasht funksionit e po ka lëndime të femijëve.

Argjend Tasholli, kam disa pyetje, rruga Gadime-Gllavicë dhe rruga e varrezave në lagjen Ejupi a planifikohen këto dy rrugë të bashkohen me asfalt. Vendosja e shportave rreth lumit në qendër të Gadimes ku asnjëherë nuk pastrohen nga kompania pastrimi. Salla që është duke u renovua në Gadime a do t'i plotësoj kushtet për zhvillimin e lojrave të voleybollit kur dihet që ne e kemi një ekip që garon në super ligë dhe duhet t'i zhvilloj ushtrimet. Si dhe rruga e lumit ku mbeturinat janë vendosur rreth lumit dhe ajo rrugë është e pa kalushme.

Nehat Terpeza, kërkoj nga ana juaj Kryesues dhe nga asambleja që të shqyrtohet Rregullorja e Kuvendit pasi që po shkelet kjo Rregullore nga disa asambleist duke i shtruar më shumë se dy pyetje dhe kërkoj që neni 29 pika 3 të ndryshohet pjesa ku thuhet kanë të drejtë t'i bëjnë dy pyetje jo më shumë.

Fauz Xhemajli, Nënkryetar i Komunës, në Glllogovc është kah punohet dhe kemi në tender te prokurimit edhe nriçimin publik. Sa i përket këndit të lojërave ai projekt ende nuk ka përfunduar, ndërsa për dezinfektim nuk kemi planifikuar pasi që nuk kemi pasur ndonjë rast problematik në komunën tonë, por në të ardhmen duhet me planifiku.

Imer Rustemi, inspektoriat ka parapa që prej datës 15 qershor të bëhet inspektimi i vazhdueshëm i të gjitha pishinave në teritorin e komunës së Lipjanit.

Ilir Tasholli, sa i përket fontanës në shesh paisja ka pasur një defekt dhe ajo shumë shpejt do të rregullohet. Po ashtu edhe dritat brenda javës do të rregullohet te busti i Adem Jasharit. Projekti i lodrave në Sllovi është duke u punuar por ende nuk ka përfunduar dhe secili prind duhet të kujdeset për fëmijët e vet. Pasi që ende nuk është i gatshëm me u shfrytëzu prej fëmijëve. Shportat e mbeturinave në Gadime po pastohet por edhe ne si qytetarë duhet të jemi më të kujdesshëm gjat herdhjes së mbeturinave. Glllogovci është fshati që prinë për nga investimet në komunën e Lipjanit.

Albulena Kelmendi, unë nuk mendoj që është Glllogovci më i rregullumi sa i përket infrastrukturës, ndërsa sa i përket fushatave senzibilizuese është mirë që edhe komuna me i qu ndonjëherë inspektorat me i denu ata qytetarë të cilët po i hedhin mbeturinat. Ndërsa ajo më shqetësuesja është çështja e lokacionit të varrezave në fshatin Glllogovc.

Nazmi Krasniqi, a ka ndonjë kontrollë nga inspektoriat që vërteton që uji i pishinave është i pastërt. Sa i përket emërimit të rrugëve është kërkesë e qytetarëve dhe nuk mendoj që është dasht të pritët kaq gjatë.

Daut Azemi, Kryesues, sa i përket varrezave në fshatin Glllogovc ne presim ndonjë kërkesë nga qytetarët për lokacionin e tyre më të përshtatshëm. Sa i përket emërimit të rrugëve të reja shumë shpejt do ta bëjmë një komision në Kuvend dhe do të vendosim.

Ukë Kryeziu, prindërit kujdesen sa i përket parkut të lodrave por duhet edhe kompania që të i vendos masat e sigurisë.

Naim Jahiri, ne banorët e fshatit Sllovi kemi bërë një kërkesë që të vendosen disa pengesa në rrugë nuk e dijë deri ku ka shku procedura, po ashtu është kërkesë e një qytetari që në rrugën "Haxhi Kleçka" të vendosen dy pengesa.

Hyra Bytyçi, kam një kërkesë për inspektoriatin policorë që të shtoj masat e sigurisë në komunikacion dhe të rrisë numrin e patrollave policore për rrugët lokale dhe regjionale kur dihet se tani është rritur fluksi i madh i bashkatdhetarëve.

Ilir Tasholli, sa i përket kërkesave të policëve të shtrir, pengesave në rrugë kemi numër të madh por Kryetari i komunës e ka caktuar një komision prej 3 anëtarëve dhe ata do të dalin do të shikojnë në teren.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Terpeza, në mbledhjen e kaluar kam thënë se janë nxënë 10 kg drogë nëpër shkolla në teritorin e Kosovës e jo në Lipjan.

Meqë vërejtje tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 20-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për

Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 20-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2019.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, drejtori dha sqarimet e tij por nuk ngriti asnjë shqetësim asnjë vërejtje e dihet që ka, kur dihet që në kategorit e veçanta ka shpenzim të ulët. Subvencionet transferet kanë një shpenzim të ulët, po ashtu te investimet kapitale ka shpenzim shumë të vogël që është për t'u brengosur. Te grantet qeveritare shpenzimi është shumë i ulët. Po ashtu nga të hyrat vetanake te investimet kapitale shpenzimi është shumë i ulët. Po ashtu nga të hyrat vetanake të bartura te subvencionet dhe transferet kemi shpenzim të vogël. Te shërbimet publike te granti qeveritarë shpenzimi është edhe këtu shumë i vogël. Te bujqësia dhe zhvillimi rural janë shpenzuar pak mjete dhe duhet me ditë se a i vënë mjetet tash bujqëve apo në shtator. Te kujdesi primar shëndetësor kemi shpenzim minimal. Te kulturë, rini dhe sport përqindja është zero nuk është shfrytëzuar ende asgjë. Po ashtu edhe te arsimi fillor kemi shpenzim mjaft të vogël. Kam një pyetje që në raporte tjera me u specifiku cilat projekte bëhet fjalë. Në përgjithësi një buxhet i shpenzuar pak dhe është për t'u brengosur.

Shkelzen Bislimi, raporti i shpenzimeve për vitin 2019 nxjerrë në pah sfidat e vazhdueshme kur bëhet fjalë për mënyrën e menaxhimit dhe shpenzimeve të buxhetit. Po thuaj asnjë raport qoftë 3 mujor apo 6 mujor nuk dallon nga vitet e mëparshme dhe përqindja e shpenzimeve është idantike nga viti në vit. Gjithnjë kemi shpenzime të larta në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa të ulëta në kategorinë e investimeve kapitale. Nëse për 6 muaj janë shfrytëzuar 80% të mjeteve çka do të ndodh me 6 mujorin e dytë. Komuna vazhdon të humb mjete nga numri i madh i vendimeve gjyqësore të cilat janë shqetësuese dhe komuna nuk është dashtë ta lejoj me shku deri këtu.

Nazmi Krasniqi, te investimet kapitale është një vlerë e vogël por ajo çka është me rëndësi projektet të cilat po punohen duhet të shikohen e jo të kryhen shkel e shko por punët të kryhen mirë.

Latif Ramadani, dinamika e shpenzimeve është tu shku në bazë të planifikimit të cilin e kemi bërë dhe do të përfundohen të gjitha projektet të cilat janë planifikuar. Fondet nga donatorët nuk janë shfrytëzu për shkak të një ankese që ka qenë në OSHP. Na në mënyrë strikte mundohemi t'i përmbahemi planifikimit të buxhetit. Sa i përket vendimeve gjyqësore ne nuk kemi mënyrë tjetër për t'i paguar ato mjete dhe nuk e ka këtë problem vetëm komuna e Lipjanit por të gjitha komunat.

Lulzim Rustemi, shërbimet tjera kontraktuese cilat janë dhe te bujqësia mjetet po shkojnë aq von çfarë planifikimi është ky.

Latif Ramadani, shërbime tjera kontraktuese janë mirëmbajtja e parqeve, sigurimi i komunës etj. ndërsa sa i përket bujqësisë janë procedurat e prokurimit ato që na vonojnë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën e tretë.

III

Propozim vendim për miratimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit të Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor-Shëndetësor (2020-2024).

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, është mirë që është bërë kjo strategji por unë kam disa vërejtje teknike dhe përmbajtësore ku te faqja 11-të te rrjeti institucionet shëndetësore IKPSH këtu janë paraqitur të gjitha QMF-te dhe AMF-të dhe kjo strategji duhet të përdoret për rritjen e shërbimeve karshi qytetarëve dhe duhet të bërë një ndryshim ku kemi AMF-në në Kraishtë dhe Sllovi që punojnë nga ora 8,⁰⁰ deri në ora 15,⁰⁰ e ku do të ishte mirë këto komuna me i shndërru në QMF.

Këtu nuk janë përfshi shërbimi i samatologjisë dhe materniteti, ndoshta është bërë ndonjë gabim teknik. Ndërsa në faqen 27 te burimet njerzore janë përshkru nevojat por nuk po e shoh që është planifiku një gjinekolog te shtimi i stafit. Po ashtu nuk është planifiku numri i punëtorëve të mirëmbajtjes e që është shumë e nevojshme. Nuk është planifiku as ekipi i patronazhit. Po ashtu është edhe një gabim teknik te faqja e parë ku duhet të shënohet Kryetari i Komunës e jo Kryetar komune.

Ukë Kryeziu, edhe unë pajtohem me drejtoreshen që komunës së Lipjanit po edhe krejt Kosovës i ka mungu kjo strategji, për të cilën është dashtur punë dhe angazhim dhe donatori kryesor ka qenë AQH. Metodologjia e strategjisë është e duhur mirëpo disa të dhëna nuk korospodojnë me gjendjen që e kemi. Kemi disa lëshime ku duhet të merret numri i vizitave nga viti i kaluar jo numri total në secilën qendër si dhe çfar shërbime ato ofrojnë dhe ta dijmë gjendjen shëndetësore të popullatës në komunën e Lipjanit. Po ashtu duhet të merren për bazë smundjet që na përcjellin në komunën e Lipjanit. Kemi problemin me dializë që është smundje që i kushton komunës së Lipjanit. Dhe në strategji duhet të përfshihet edhe ky problem. Po ashtu duhet të fokusohet në grupet më të rrezikuara në shoqëri që janë fëmijët dhe të moshuarit. Strategjia që neve na u ka paraqit është teknike dhe jo strategji për komunën e Lipjanit. Duhet që edhe Kraishta edhe Sllovia të bëhen QMF siqë e përmendi edhe më heret kolegëja. Kemi AMF në Smallushë por nuk është aspak funksionale ku gjatë vitit nuk dalin më shumë se 20 vizita. Me këtë strategji nuk do të rriten shërbimet dhe nuk do të ndryshohet asgjë.

Vlora Limani-Hajnuni, kjo strategji është mirë që është bërë dhe kurdo mund ta ndryshojmë. As ministria e shëndetësisë nuk ka ndonjë strategji për kujdesin parsorë shëndetësorë.

Nuk duhet ketë dallime në mesë të QKMF-ve dhe AMF-ve por do të duhej që të gjitha të japin shërbim të njëjtë por kjo është e caktuar me udhëzim administrativ prej ministrisë. Sa i përket shëndrrimit të AMF-ve në QMF kjo është e drejtë që i takon Kuvendit. Ne i kemi 226 punëtorë dhe nuk mundemi që të marrim punëtorë të mirëmbajtjes e ta zvogëlojmë numrin e dokëtorëve ose të motrave pasi që stafi ndahet në bazë të numrit të banorëve. Në faqen 12 dhe 14 të strategjisë e gjeni se cilat shërbime mund t'i gjejnë qytetarët në QKMF dhe AMF.

Anila Reçica- Llugini, plani i veprimit është për tu vlersuar dhe ne si grup parlamentar e përkrahim .

Nazmi Krasniqi, shihet se është bërë diçka por duhet të bëhen analiza nga niveli qendror dhe ekspertët që të përmbillet kjo çështje. Në përgjithësi kemi mjek të mirë por mjetet aty janë shumë të vjetra ku nëse shkon te stamatologjia dhe e sheh në çfar gjendje është. Kam një pyetje për fund me cilat sëmundje ballafaqohen më së shumti qytetarët e komunës së Lipjanit.

Albulena Kelmendi, unë pajtohem me shumicën nga parafolësit por nuk pajtohem që mos t'i lihet faji edhe nivelit qendror sa i përket shëndetësisë pasi qe 20 vite niveli qendror nuk është kujdesur aspak sa i përket kësaj çështje. Ne duhet me u pajtu me këtë strategji e në veçanti me sfidat që i ka paraqit drejtoresha e cilat duhet të mundohemi t'i përmirësojmë. Ajo që më shqetëson mua është ekipi i patronazhit por shpresoj që ajo është në procedurë dhe do të funksionalizohet. Po ashtu ideja e fushatave senzibilizuese nepër shkolla do të ishte e mirë por për momentin nuk e di që është duke u praktikuar. Është mirë që me u mbajt trajnime dhe seminare për stafin mjekësor që të shkëmbejnë përvoja me njëri tjetrin.

Egzona Bytyqi, jam pro perpilimit të një strategjie të tillë. Por nga informatat që i kam nga QMF në Shalë prej momentit që është hap ajo qendër, nuk ka pasur servisim të aparaturës, e sa do të dalin rezultatet e analizave të sakta është një pikëpyetje e madhe. Çështja tjetër QKMF në Shalë nuk ka as gliko metër ku për matjen e sheqerit qytetari detyrohet nga Shala të vijë në Lipjan. Po ashtu as kontinjer për mbledhjen e mbeturinave. Dhe në fund vizitat shtepiake të cilat personeli i bënë vet a ka ndonjë plan për to.

Afrim Miftari. është një dokument i rëndësishëm për të cilën drejtoresha tha se është i bazuar në bazë të hulumtimit në teren por ne do të presim se si do të implementohet.

Arben Saliju, kam një pyetje sa kish pas mundësi që stafi mirëmbajtës me u zëvendësu me staf mjekësorë, ndërsa pjesa tjetër me u plotësu me një kompani prej jashtit.

Hyra Bytyçi, strategjia është bërë në mënyrë profesionale por kemi raste kur mjeku jep barna dhe diagnoza, ndërsa farmacisti shpesh gabon dhe e ndryshon kjo duhet të rregullohet .

Vlora Limani-Hajnuni, sa i përket strategjisë sëmundjet i keni të cekura në faqen 8-të, ndërsa stamatologjia mund të përmirësohet por propozimet vijnë nga Kuvendi dhe ju jeni ata të cilët mund ta ndryshoni. Ekipen e patronazhit e keni të përfshirë në strategji. Sa i përket trajnimeve ose seminareve personeli mjekësorë e ka kushtë me i kry nëse don me e marrë licencën. Mirëmbajtja e aperiatores shëndetësore është problematike pasi që duhet të ceket në kontratë çdo pjesë e cila do të servisohet por e kemi fillu një procedurë në prokurim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, do të shkon si propozim që AMF në Kraishtë dhe Sllovi në të ardhmen me u shëndrru në QMF.

Vlora Limani-Hajnuni, ekzekutivi i propozon por Kuvendi është ai që mundet me e ndryshu mos me votu por duhet t'i jep edhe alternativat e veta. Ndërsa sa i përket mirëmbajtjes së QKMF-së unë e kam bërë një paralogari dhe si duket më lirë do të ishte nëse do të privatizohet.

Ganimete Qeriqi, pajtohem me drejtoreshen por edhe me ate që e than parafolsit por kur u fol nga drejtoresha që buxheti të shkoj më shumë në shëndetësi pat disa asociacione nga disa kolegë, kur dihet se në shëndetësi edhe buxhetin e Amerikes po ta bije nuk do të mjaftonte. Shëndetësia ka zgjidhje por i duhet një formulë.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 18 vota për, 4 kundër, 5 apstenime aprovoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR KUJDES PARËSOR-SHËNDETËSOR (2020-2024)

Neni 1

MIRATOHET, Strategjia dhe Plani i veprimit të Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor-Shëndetësor (2020-2024).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia dhe Plani i veprimit i Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor-Shëndetësor (2020-2024).

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

Pastaj Kryesuesi dha pauzë nga ora 12²⁰ deri në ora 14⁰⁰

IV

Raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2018.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Avni Ollurit, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, a e keni përpiluar ju raportin apo ju ka ardhur i gatshëm pasi që ka mos përputhje për shembull në një vend thotë se janë 12 rishiqime, ndërsa në tabel 15 ose kemi në tabel 3,6,7,8,9 dhe 10 ku ka dalë performanca më e ulët por nuk është e specifikuar se cilat janë dhe nuk janë sqaruar mirë. Te uji i pijshëm mund të jetë i shtrirë rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit por nuk është në nivelin e duhur ose për shembull te parkingjet nuk është nivel i mesëm por është nivel i lartë. Ndërsa niveli më i ulët mbesin rrugët dhe trotuarët që ju mbetet juve shumë për me punu. Po ashtu ju mbetet me punu rreth ujërave të zeza, hapsirave të gjelbërta, punësimit të personave me aftësi të kufizuara etj.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-se e kemi shqyrtuar këtë raport dhe ne konsiderojmë që komuna e Lipjanit ka një performancë të mirë falë punës së ekzekutivit. Ku komuna e Lipjanit po shënon rritje nga viti në vit. Ku fushat me efikasë janë transparenca dhe llogaridhënja.

Afrim Miftari, edhe ne si grup e kemi shqyrtuar por kam një kërkesë që në të ardhmen kur të na vijë shkresat t'i kemi edhe numrat e faqeve.

Avni Olluri, te pjesa e tabelave është e shënuar mbrapa sçarimi. Dhe vlersimi që i është bërë komunës së Lipjanit është e pa drejtë pasi që te disa rrugë edhe pse janë rrugë publike dhe nuk shfrytëzohen rrugë të arave dhe për këtë arsye vlerësimi ka ardhur jo i kënaqshëm.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në piken e 12-të të rendit të ditës për shkak të një arsye familjare të drejtorit të DKA-së.

XII

Informatë, ecuria e procesit mësimor në periudhën Janar-Qershor 2019.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, deshta ta ngris një shpëtim rreth transportit të nxënësve ku ka pak ulëse dhe mbushet me nxënës sikur të ishin peshqi, propozoj që ata autobus me u ndrru sepse janë shumë të vegjël. Shqetësimi i dytë rreth nxënësve të fshatit Suhadoll të cilët vijnë mësimet në Lipjan. Po ashtu si ngecje është dashtë të ceket edhe narkotikët nëpër oborret e shkollës por edhe brenda objekteve shkollore.

Albulena Kelmendi, arsimit sikurse edhe shëndetësia është një fushë vitale ku do të duhej të eprin kontributin të gjithë. Ne nuk mundemi të kërkojmë edhe shumë nga niveli lokal kur e dijmë që në nivelin qendrorë i kemi punët shumë keq, çdo ditë me eksperimente të kolikulave të ndryshme. Neve nuk na kanë ardhur informata të detajuar rreth këtyre dy viteve shkollore, këtu janë paraqitë testi i arritshmërisë, testi kombëtar, e ku për mendimin tim janë arritë rezultate më të mira që i kemi pritë. Ajo çka është e mangët në këtë informatë janë mungesat e shumta të nxënësve, sukseset e nxënësve, mungesa e arsimtarëve të gjermanishtes, çështja e narkotikëve, greva, orët e humbura etj.

Bashkim Budakova, kjo informatë len shumë për të dëshiruar ku te shumë maturant rezultatet len për të dëshiruar. Nuk mund të flasim për përmirësim të arsimit deri sa kemi mungesa të laboratorëve, punsime partiake. Ne po e ngrisim zërin kundër degradimit të arsimit pasi që arsimit është tu shkuar kah arsimit elektorial. Edhe një pyetje konkrete për drejtorin a kemi raport të psikologëve për gjendjen e përgjithshme të shkollave.

Nazmi Krasniqi, sa i përket kësaj informate nuk është e cekur cilësia në arsim e as rezultatet e gjysëmvetorit të parë, po ashtu testi i maturës dhe semimaturës nuk është i

knaqshem aspak. Ne ende skemi arrit ta bëjmë një shkollë me mesim tërë ditorë në komunën e Lipjanit. Nuk kemi as informata të mungesave të arsimtarëve as të nxënësve nepër shkolla.

Anila Reçica, ne jemi për me zbatu kulikulen pasi që ajo vjen nga niveli qëndrorë. Rezultatet e testit të maturës në gjimnaz janë të mira, ndërsa në “Adem Gllavicë” kemi pak ngecje, ndërsa sa i përket punësimit ne jemi shembull për punësim të rregullt, ndërsa nëse dikush ka punësuar pa kritere ka qenë qeverisja e kaluar.

Lulzim Rustemi, një informatë e mangët e varfër dhe shumë siperfaqësore, nuk kemi asnjë informatë rreth cilësisë së arsimit, mungesave të nxënësve, nxënësit pa notuar etj. Çe sa kërkesa i kemi pasur rreth kësaj informate dhe në fund vjen kjo informatë që nuk ja vlen për të diskutuar. Ne ende vazhdojmë me i avansu njerzit partiak dhe nuk ceken hapsirat e shkollave, kabinetet etj.

Albulena Kelmendi, sa i përket kulikules unë vet e zbatoj por jena në një far faze eksperimentale nga esperimet të ndryshëm e sa janë të gatshëm nxënësit me akceptu korikulen kjo është diçka tjetër. Sa i përket mungesave nuk është veç puna e një nxënësit që nuk të vjen në orë por kemi nxënëxe të cilët e kanë lënë shkollën, nxënësja që janë dalë jashtë shtetit, ka nxënësja që janë mbetë pa notu dhe krejt këto është dashtë me u evidentu. Arsimi në Lipjan ka ndryshu në disa çështje por prap se prap nuk është mirë. Po ashtu edhe punës së psikologëve nuk kemi asnjë raport.

Nazmi Krasniqi, na jemi tu diskutu për arsimin tash e tutje ku te testi i matures janë caktuar njerz partiak po ashtu edhe te çështja e punësimit. Duhet të përmendet që edhe greva në arsim që ka shkaktuar probleme.

Fatime Krasniqi, nëse duhet të përmendet dikush për të keq është qeverisja e kaluar e cila e ka shkatrru arsimin. Ku në fshatin Akllap drejtorin me drejtim të mashinerisë e ka bërë drejtor. Nëse dikush nuk duhet me kriritiku arsimin në Lipjan ajo është PDK-ja e cila ka bërë punësime jo adekuate pa diplomë, punësime partiake etj.

Nazmi Krasniqi, gjene vetem një punëtorë që ka punuar në ciklin e ulët të pa kualifikum unë jap llogari.

Rasim Hasani, në faqen e fundit të informatës i keni sfidat. Ju keni lyp një informatë dhe ne ju kemi sjellë në vija të trasha krejt ajo çka ka ndodh. Qe 5 vite çdo i punësuar hynë në punë në arsim në bazë të konkursit bile ate edhe zëvendësimet. Të pakten ju të pushtetit të kaluar nuk është mirë me folë për arsim pasi që ende po na pengojnë puna juaj e kaluar. Ne kemi punëtorë e në mesin e tyre një asambleist këtu në sallë i cili është punësuar para 5 vite, ndërsa tash e ka marrë pagën. Ne po duhet me i pagu punën që e ka bërë qeverisja e kaluar.

Albulena Kelmendi, informata u kanë qaq jo voluminoze sa që për 5 minuta ke mujt me lexu, 12 sfida janë të cekura këtu dhe prej atyre që i ceka unë asnjëra nuk është këtu.

Bashkim Budakova, du me u lidh me fjalimin e famshëm të drejtorit që e përmendi 6 herë fjalën nuk kuptoj unë e di nga shkolla e mesme se sa din e sa kupton. Unë në mandatin e këtij drejtori kam aplikuar në 13 konkurse dhe më është mohuar e drejta vetem se nuk i takoj këtij subjekti. Pata edhe një pyetje rreth psikologëve por nuk mu përgjigj.

Rasim Hasani, unë nuk lejoj kërken me më fy në baza personale, ndërsa sa i përket asaj se ke apliku për punë dhe nuk je pranë ka edhe tjerë të kanë apliku por nuk janë pranë. Nuk mundem me sjellë për secilin veç e veç raport sot për psikolog njerz për gjuhëtarë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën e pestë te rendit të ditës.

V

Propozim vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Argjend Tasholli, bazuar në nenin 4 paragrafi 1.5 parimi i ruajtjes së pronës ku, sipas këtij parimi nuk është dashur as të diskutohej e leje më të ipet në shfrytëzim e të shkatërrohet turizmi në fshatin Gadime, paragrafi 1.6 parimi i ruajtjes së pronës ku prona nuk po ruhet por vetëm po shkatërrohet në Gadime. Gadimja duhet të trajtohet ndryshe dhe kërkesë e imja është që të themi jo shkatërrimit të Gadimes e t'i lëjmë interesat personale kur është në qështje interesi i Gadimes. Me dhënien në shfrytëzim të pronës 01049-15 po shkatërroni turizmin e Gadimes dhe pishat e Gadimes për interesa personale të disa individve.

Shkelzen Hajdini, ne jemi duke vepru sipas Ligjit dhe komuna ka të drejtë në menagjimin e pronave komunale, ndërsa asambleistët janë ata të cilët vendosin për dhënien në shfrytëzim ose jo.

Argjend Tasholli, kam një pyetje parcela 01049-15 a është parcel e re.

Albulena Kelmendi, ne edhe në KPF e kemi dhënë mendimin tonë po e përsërisë prap që jemi kundër këtij propozim vendimi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 15 votat për, 11 kundër, aprovoi këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjinden në Zonën kadastrale Gadime e Ulët të paraqitura në tabelën si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura - klasa	Sipërfaqe m ²
1	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01048-0	Gadime e Ulët	----	5801
2	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-6	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	50000
3	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-15	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	40419

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale ipen në shfrytëzim në afat prej 16 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është shfrytëzimi i shkëmbinjeve-seperim të gurëve apo të ngajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 16 vitesh.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK Gadime e Ulët.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi ku i njoftoj se Kryetari për komision ka propozuar Shkelzen Hajdinin, Ilir Tashollin dhe Denis Gashin.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, në propozim vendim po shënon se dy anëtarë nga ekzekutivi 1 nga shoqëria civile dhe 2 nga legjislativi por nuk po ceket se cilat parti, dua një sçarim rreth kësaj çështje dhe kisha propozu që të përfshihen edhe subjektet tjera jo vetëm subjektet e mëdha por të përfshihen edhe subjektet tjera.

Nehat Tërpeza, unë propozoj për anëtarë të komisionit nga LDK-ja, Majlinda Sylejmani Egzona Bytyqi, e propozoj Ramiz Qeriqin, nga PDK-ja anëtar të komisionit. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se kjo është përbërja e komisionit.

- 1.Shkelzen Hajdini,
- 2.Ilir Tasholli,
- 3.Denis Gashi
4. Majlinda Sylejmani
5. Ramiz Qeriqi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 23 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GADIME E ULËT

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-48346 i datës 19. 07. 2019 (në vazhdim të tekstit: Komisioni) formohet në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.
2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
2. Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike nga ekzekutivi i Komunës
3. Majlinda Sylejmani nga subjektet politike
4. Ramiz Qeriqi, nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-14811 të datës 04.03.2019 .

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dipozitive tjera të akteve nënligjore që do të derivojnë nga Ligji.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit në pronësi të Komunës në rrugën “Lidhja e Prizrenit”

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdinit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi. Pastaj tha se nga ekzekutivi janë propozuar Latif Ramadani, Bekim Shabani dhe nga shoqëria civile Gentrit Zogaj.

Daut Azemi, tha se nese pajtohet grupi parlamentar i LDK-së kisha propozu diken nga kualicioni për anëtarë.

Hyra Bytyçi, po ne pajtohemi që për anëtarë të jetë dikush nga kualicioni.

Afrim Miftari, e propozoj për anëtare të komisionit Safete Amerllahun

Lulzim Rrustemi, edhe ne pajtohemi që në këtë komision të propozohet dikush nga subjekti që vjen pas neve.

Albulena Kelmendi, unë propozoj Shkelzen Bislimin.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se propozimet janë:

1. Latif Ramadani,
2. Bekim Shabani,
3. Gentrit Shabani,
4. Safete Amerllahu dhe
5. Shkelzen Bislimi

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË LOKALIT NË PRONËSI TË KOMUNËS
NË RRUGËN “LIDHJA E PRIZRENIT”

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-203 të datës 29.03.2019 (në vazhdim të tekstit: Komisioni) në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa nga ekzekutivi i Komunës
2. Bekim Shabani, Drejtor i DKRS nga ekzekutivi i Komunës
3. Safete Amerllahu nga subjektet politike
4. Shkelzen Bislimi nga subjektet politike
5. Gentrit Zogaj nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-20393 të datës 29.03.2019 .

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dipozitive tjera të akteve nënligjore që do të derivojnë nga Ligji.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VIII

Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve në pronësi të Komunës në sheshin “Adem Jashari”

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdinit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi. Nga ekzekutivi janë të propozuar: Latif Ramadani, Bekim Shabani dhe Gentrin Zogaj.

Pastaj Kryesuesi Hapi diskutimin?

Hyra Bytyçi, propozon, Arben Salihun

Lulzim Rrustemi propozon, Bashkim Budakoven

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË LOKALEVE NË PRONËSI TË KOMUNËS NË SHESHIN “ADEM JASHARI”

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim

afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-67001 të datës 01.11.2018 (në vazhdim të tekstit: Komisioni) në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa nga ekzekutivi i Komunës
2. Bekim Shabani, Drejtor i DKRS nga ekzekutivi i Komunës
3. Arben Salihu nga subjektet politike
4. Bashkim Budakova nga subjektet politike
5. Gentrit Zogaj nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3

Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-67001 të datës 01.11.2018 .

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dipozitive tjera të akteve nënligjore që do të derivojnë nga Ligji.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IX

Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor, i DBF-ca, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, gjatë një vështrimi të shkurtër hasim në mangësi e shumë gabime të gjetura nga auditori ku ne si qytetarë na japin dyshime të mos dijes apo ndonjë trendi të manipulimit. Raporti aktual i auditimit ka pika shqetësuese sa i përket auditimit duke e konsideruar si aspak të knaqur shpërndarje e buxhetit për vitin 2018 ku realizim i dobët kemi te investimet kapitale. Shum projekte të fituara nga donatorët e jashtëm nuk kanë filluar të zbatohen. Gjetja më shqetësuese është te të hyrat e tatimit në pronë. Ky raport paraqet gjendjen reale në të cilën përballlet qytetari i Lipjanit.

Lulzim Rrustemi, pasqyrat finciare paraqesin një pamje të drejtë, por kemi edhe shumë të gjetura siq janë pagesat për arsim ku llogariten si keq klasifikim. Planifikimi i buxhetit në prokurim dhe personel kërkon përmirësim të vazhdueshëm. Qështja kyqe e auditimit është se mundësia e kthimit është e vogël. Sa i përket qirave të lokaleve dhe taksive nuk egzistojnë fare. Fusha e prokurimit dhe e zbatimit të kontratave mbetet fusha më shqetësuese. Fusha tjetër shqetësuese është realizimi i buxhetit klasifikimi dhe subvencionet, po ashtu realizimi i ulët i buxhetit. Po ashtu auditori ka gjetur shkelje të tatimit në pronë ku anketuesit në teren shihet se nuk janë të nivelit të duhur. Po ashtu mungesa e vonesës së lëshimit të lejeve ndërtimore është një e gjetur. Nga viti i kaluar rekomandimet nga 15 , prej tyre 2 nuk janë zbatuar fare.

Hyra Bytyçi, Ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar raportin e auditimit për komunën e Lipjanit për vitin 2018. Ky raport ka për qëllim analizimin dhe kontrollimin e pasqyrave financiare vjetore mbas të së cilit janë përmbledhur qështjet kryesore që duhet të auditohen nga zyra kombëtare në përputhje me standartet ndërkombëtare. Auditimi është fokusuar kryesisht tek kontrollimi dhe menaxhimi i pasqyrave në bazë të cilave është dhënë opinioni. Edhe këtë vit vlerësimi i auditorit për komunën e Lipjanit është i mirë "opinion i pa modifikuar" dhe këtë vit kemi opinion më të mirë në nivel vendi ku nga 15 rekomandime në vitin 2017 këtë vit kemi vetëm 8 rekomandime.

Latif Ramadani, komuna e Lipjanit këtë vit nga auditori është vlerësuar në mënyrën më të mirë të mundshme sa i përket auditimit. Të gjitha obligimet nga vitet e kaluara ne jemi duke i paguar dhe neve thesari nuk na pyet se ku me i marr mjetet. Ku prej 15 rekomandimeve 10 janë kryer ndërsa 3 janë në proces dhe 2 ende nuk kanë filluar.

Lulzim Rrustemi, këto të gjetura janë të shkruara ku nga 5 raste të tatimit në pronë 4 janë gjetur me gabime, dhe këto të gjetura duhet me i identifikuar dhe me i tejkaluar.

Latif Ramadani, ajo që është në raport nuk mund ta mohojmë, dhe ato rekomandime të cilat i kemi ne do të mundohemi që t'i përfundojmë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën e dhjetë te rendit të ditës.

X

Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, drejtor, i DBF-ca, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Argjend Tasholli, ju duke permendur te kaluaren po e shkatroni të ardhmen, e kaluara duhet te mbetet vetëm një histori dhe të mos përsëritet kur është në pyetje shkatrimi i një vendi e duhet ta shikojmë të ardhmen tonë, ta mbrojmë atë nga shkatrimi. Gadimja nuk ka nevojë për gurthyes pasi që Gadimja vizitohet nga 2000 vizitorë në ditë, prioritet duhet ta keni turizimin e jo ta shkatroni atë. Pres nga bashkëvendasit e mi të votojnë kundër, të votojnë për të mirën e fëmive të tyre.

Shkelzen Hajdini,shkatrimin nuk jam t'u e bërë une.Une jam vetem kryetar i komsisionit të cilën e keni votuar ju asambleja komunale.

Afrim Miftari,është mirë atyre që po i përpilojnë këto shkresa të ceken edhe nr e faqeve,ku këtu te faqe 1 është dasht të shënohen edhe anarët e komisionit pasi që ata anëtarë janë votuar prej ketij kuvendi.Edhe nuk kemi pas qef me votu po ata kanë qenë edhe ma herët aty dhe është ma mirë me u menagju dhe kontrollu në mënyre institucionale.

Shkelzen Bislimi,unë kam qenë anëtar i komsisionit për neve ka qenë e vështire pasi ata qe nje kohë janë t'u operu pasi që kanë licencë dhe me dhimben disa kompani të cilat nuk janë përfituese për shkak se ata nuk i kanë plotsu kriteret dhe nuk kanë qenë serioze.

Argjend Tasholli,ata gurthyes kanë fillu në regjimin sllav dhe na është dashtë me i ndërpe ata gurthyes.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 17votat për,11 kundër aprovoi këtë:

XI

Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdinit, drejtor, i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.Ku sipas propozimit të kryetarit nga ekzekutivi janë:Shkelzen Hajdini ,Ilir Tasholli dhe nga shoqria civile Denis Gashi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Hyra Bytyçi,propozoj për anëtarë të komisionit Majlinda Sylejmanin.

Argjend Tasholli, ne si grup parlamentar e prpozojna Nazmi Krasniqin.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 28votat për, aprovoi këtë:

XIII

Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën,Radmilla Simionovic, i cilia në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi,si subjekt e përkrahim çdo iniciative për kthimin e të shpërngulurve,por nuk e di ku ju keni referu të dhënave pasi që në fagen 4 thuhet para vitit 1999 në këtë komunë kanë jetuar një numër më i madh i komuniteteve,mund të themi një numër më i madh por shumica e qytetarëve në komunën e Lipjanit kanë qenë shqiptarë ku jeni referu që e keni marrë këtë statistikë nashta mundeni me na sqaru.

Hyra Bytyçi,deshta me u ndal te pika 5 nenpika 4.4 të shëndetësia. Komuniteti serb shërbimet primare i merr nga institucionet serbe të vendosura në një kontenjer në pronën e kishes ortodokse serbe në Lipjan.Nëse ata dojnë të zhvendosen duhet t'i u përmbahen kushteve qe na ju ofrojmë.

Radmilla Simionovic,kjo është gjendja momentale sa i përket shëndetësië por në të ardhmen ndoshta mujna me ndryshu me kalu ne ambulanta. Ndërsa sa i përket pyetjes se Albulenës na të dhanat i kemi marrë nga UNHCR.

Arben Salihu,kjo qendra kontenjer që është te kisha a është në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë.

Daut Azemi,këta po e tregojnë vetëm gjendjen reale neve na mbetet në të ardhmen qysh
mujna me inkorporu.

Albulena Kelmendi,kisha dashtë me u përfshi një fjali ku në këtë plan të veprimit nuk
përfshihenë rastet e viteve të 90-ta si plan i konolizimit kur ishin sjellë dhe vendos serb nga
Kroacia dhe bosnja.

Radmilla Simojonovic,plani është bazuar në bazë të rregullores së qeverisë

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe
pas votimit Kuvendi konstatoi se me 22 votat për ,1 kundër 5, apstenime, aprovoi këtë:

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,³⁰

Ekstraktin e hartoi
Behar Ali

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi